

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LINDITA S. LLESHI**



V2021051100065450435

**DATE 02/07/2021
NR REP 868**

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 02/07/2021, para meje Notere LINDITA S. LLESHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën BLV"BAJRAM CURRI", PALL"1MAJI", SHK.9, AP.20, NJ.ADM.NR.5, Tiranë , u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Manjola Sopoti, atësia Flamur, amësia Fiqirete, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë E Kavajës; Nd. 225; H. 2; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 23/03/1976, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjofim ID nr. 033821295 dhe nr. personal H65323146W ,

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, ie cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur gazete e regjistrit tregëtar te Dinizli Turqi nr 31580 shoqeria EBS shpk -germim transport ndertim miniera ,turizem ,ushqim,bujqesise industrise dhe tregëtise, nga gjuha turke në gjuhën shqipe me apostille dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë;" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

LINDITA S. LLESHI





(Vulë lidhëse)

APOSTILË
(Marrëveshja e Hagës e datës 5 Tetor 1961)

1. Shteti : **TURQI**

Ky dokument zyrtar

2. Është nënshkruar nga **Nebahat ADIGÜZEL**
3. Funksioni i nënshkruesit **Drejtor i Regjistrit Tregtar**
4. Mban vulën e **Dhomës Tregtare të Denizli**

VËRTETËM

5. Në **Prefekturën e Denizli**
6. Në datë **24.06.2021**
7. Nga **Drejtori i Degës, Muhterem DEMIRCI**
8. Është konfirmuar me nr. **9233**
9. Vula
*(Vulë e Drejtorisë të Degës së Procedurave Ligjore
Prefektura e Denizli, Republika e Turqisë)*

10. Nënshkrimi
*(Vulë: Muhterem DEMIRCI
-Nënshkrimi)
24.06.2021*

*(Vulë-Nënshkrim i Halil ERBIL
Operator i Përgatitjes dhe Kontrollit të të Dhënave)*

*(Vulë-Nënshkrim i Muharrem YILDIZTEPE,
Përgjegjës)*

Manjola SOPOT
Përkthyesë Zyrtare
e Gjuhës Turke
Cel: 0682090777



Nga Drejtoria e Regjistrimit Tregtar të Denizli

Nr. regjistrimit: 31580 - Qendër

Emri Tregtar

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR E GËRMIMIT TRANSPORTIT NDËRTIMIT MINIERAVE TURIZMIT USHQIMIT BUJQËSISË INDUSTRISË DHE TREGTISË "EBS" (EBS HAFRIYAT NAKLIYAT İNŞAAT MADEN TURİZM GIDA TARIM SANAYI VE TİCARET LIMITED ŞİRKETİ)

Selia tregtare: Bulevardi "Acıpayam", lagjia "Bağbaşı", kompleksi "Aksoy", nr. 53/B, Qendër, Denizli.

Shpallet regjistrimi në datë 29.12.2011 i çështjeve të poshtëshënuara në lidhje me shoqërinë me selinë tregtare, numrin e regjistrimit dhe emërtimin e lartshënuar.

Lënda: Themelimi i ri

Miratimi nga Noteri i Aktit të Themelimit:

Datë 29.12.2011 dhe me numër repertitori 49147 të Noterit të 3-të të Denizli.

Vendimet dhe miratimi: Vendimi i miratuar nga Noteri i 3-të i Denizli në datë 27.12.2012 dhe numër repertitori 49149.

Akti i Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar e Gërmimit Transportit Ndërtimit Minierave Turizmit Ushqimit Bujqësisë Industrisë dhe Tregtisë "Ebs" (Ebs Hafriyat Nakliyat İnşaat Maden Turizm Gıda Tarım Sanayi ve Ticaret Limited Şirketi)

Themelimi

Neni 1:

Ndërmjet themeluesve me emrat, mbiemrat, shtetësitë dhe adresat e vendbanimit të poshtëshënuara është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Themeluesit:

Emri dhe mbiemri: Şükran Ersoy

Atësia, datëlindja dhe shtetësia: Ali-21.02.1981-Republika e Turqisë

Adresa: Lagjia "İncilipinar", rruga "İstiklal", nr. 168/6, Denizli.

Emri dhe mbiemri: Bekir Ersoy

Atësia, datëlindja dhe shtetësia: Ramazan-03.12.1993-Republika e Turqisë

Adresa: Fshati Kemerören, Fethiye, Muğla.

Emërtimi

Neni 2:

Emërtimi i shoqërisë është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e Gërmimit Transportit Ndërtimit Minierave Turizmit Ushqimit Bujqësisë Industrisë dhe Tregtisë "Ebs" (Ebs Hafriyat Nakliyat İnşaat Maden Turizm Gıda Tarım Sanayi ve Ticaret Limited Şirketi)



**Qëllimi dhe objekti
Neni 3:**




Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë të shoqërisë është renditur me pika si më poshtë:

- Shoqëria kryen vetë ose nëpërmjet të tjerëve gjurmime dhe transportime në të gjitha llojet e tokave.
- Kryen të gjitha llojet e studimit të tokës, analizën e tokës, hapjen e kanaleve ujitëse në tokë dhe të gjitha operacionet e parashikuara nga reformat bujqësore në lidhje me objektin e veprimtarisë të shoqërisë, ajo mund të hyjë në tenderat e hapur nga institucionet përkatëse publike, të fitojë tendera, t'i transferojë ato te të tjerët ose t'i nënkontrakttojë ato.
- Kontraktimi i të gjitha llojeve të projekteve të banesave, objekteve industriale, objekteve shëndetësore, sociale dhe arsimore, institucioneve dhe organizatave publike, ndërtimi i shtëpive dhe qendrave të biznesit në këmbim të pjesës takuese të pronës, blerja dhe shitja e parcelave të tokës brenda dhe jashtë vendit, projektimi, ndërtimi, blerja, shitja e tepricave, marrja me qira, dhënia me qira e banesave, godinave masive të banimit, qendrave të biznesit, depove, fshatrave turistike, qyteteve satelitore, hapësirave për ftohje, vendparkimeve, komplekseve të akomodimit, ndjekja pranë autoriteteve zyrtare vetë ose nëpërmjet personave të tjerë të autorizuar e të gjitha procedurave që lidhen me këto.
- Në kuadrin e fushës së buxheteve të përgjithshme të alokuara dhe speciale brenda dhe jashtë vendit realizimi i të gjitha llojeve të punëve publike nëntokësore dhe mbitokësore, autostradave, hekurudhave, kanaleve, urave, tuneleve, grykave, porteve, liqeneve, digave, mureve mbajtëse, sistemimi i rrjedhës ujrave dhe ndërtimi të objekteve të vaditjes.
- Pjesëmarrja në tenderat për rindërtimin ose riparimin e objekteve ndërtimore, energjisë elektrike, instalimeve, rrugëve, ujrave, kanalizimeve, gazit natyror, infrastrukturës, superstrukturës, punimeve të dekorimit dhe të restaurimit, të cilat tenderohen nga ministritë e shtetit të Republikës së Turqisë dhe institucionet e tyre zyrtare të lidhura me ministrinë, entet ekonomike publike, departamentet e buxhetit publik, administratat lokale, bashkitë, kooperativat ndërtimore, organizatat e sektorit privat në vend dhe jashtë vendit, dhënia e ofertave, nëse tenderi fitohet nga shoqëria realizimi i punimeve dhe dorëzimi i punës në përputhje me kontratë e tenderit.
- Blerja, shitja, prodhimi, eksportimi dhe importimi i të gjitha materialeve të nevojshme dhe që kanë lidhje me ndërtimin dhe objektin e veprimtarisë të shoqërisë.
- Ndërmarrja e sipërmarrjeve të përbashkëta me kompani vendase dhe të huaja dhe individë në tenderat që janë hapur ose do të hapen në lidhje me ndërtimin dhe punët kontraktuese të institucioneve zyrtare, të cilat kanë lidhje me objektin e veprimtarisë të shoqërisë, realizimi i nënkontraktimeve dhe kontraktimeve në këto tendera.
- Ndërtimi dhe vënia në funksionim e impianteve për prodhimin e materialeve që do të përdoren në operacionet e ndërtimit, kontraktimit dhe gjurmimit. Blerja, marrja me qira, dhënia me qira e makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për këto punë.
- Tregtimi, marketimi, importimi dhe eksportimi i të gjitha llojeve të materialeve të gatshme dhe gjysëm të gatshme të përdorura në prodhimin e materialeve të ndërtimit, blerja, shitja, marrja me qira, dhënia me qira e të gjitha pajisjeve të përdorura në punimet e ndërtimit dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit.
- Nxjerrja, shfrytëzimi, blerja dhe dhënia me qira e minierave nëntokësore dhe mbitokësore dhe burimeve natyrore, me kusht që të merret leja e nevojshme nga autoritetet.
- Marrja e licencës për kërkimin e mineraleve, kërkimi i mineraleve dhe për të kërkuar miniera, marrja me transferim e të drejtës minerare, përkundrejt transferimit të licensës së operimit në fushën minerare.

- Operimi me furrat e të gjitha llojeve të mineraleve, mermerit, gurëve, gëlqeres, argjilave, qymyrit, si dhe me guoret, me kusht që të merret leja nga autoritetet përkatëse.
- Kryerja e kërkimit, nxjerrjes, përpunimit, blerjes, shitjes, importit dhe eksportit të të gjitha produkteve brenda fushës së minierave, me kusht që të respektohet legjislacioni përkatës.
- Kërkimi, nxjerrja, përpunimi, tregtimi, importimi dhe eksportimi i të gjitha llojeve të gurëve të tillë si mermeri, graniti, diahazi, travarteni, oniksi, bozalti, etj, që priten dhe janë të lustrueshëm, me kusht që të respektohet legjislacioni përkatës.
- Kërkimi, nxjerrja, përpunimi i të gjitha llojeve të gurëve gjysëm të çmuar dhe të çmuar, me kusht që ato të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës.
- Kryerja e transportit vendas dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave nga të gjitha llojet e rrugëve tokësore, ajrore dhe detare. Ndërtimi, vënia në funksionim, marrja me qira, dhënia me qira e parkingeve private të automjeteve, marrja pjesë në të gjitha llojet e tenderave që lidhen me objektin e veprimtarisë, pjesëmarrja në rritjen dhe uljen e ofertave.
- Ushtrimi i veprimtarisë në fusha të tilla si hotele, motele, kamping, hostele, fshatra turistike, shtëpi pushimi, stacione termale, plazhe, pastičeri, lokale, kafeteri, oborre çaji, kafene, sallone nargjile, pishina, banja turke, sauna, zona turistike, parkingje, sporte ujore, sporte dimërore, sporte natyre, turizëm malor, turizëm spa, salla të brendshme dhe të jashtme sportive, klube nate, mal, det dhe sporte të tjera ujore dhe argëtimi me rafting, burime ujore, not dhe aktivitete të tjera sportive malore dhe ujore në këtë fushë, por këto aktivitete mund të merren me qira, jepen me qira, transferohen ose blihen, shiten, vënia në funksionalitet e objekteve dhe bizneseve të nevojshme.
- Shoqëria mund të krijojë, operojë, transferojë dhe marrë agjensi udhëtimesh në mënyrë që të ofrojë shërbime turistike në vend dhe jashtë vendit, të krijojë dhe operojë me degë të agjencive të krijuara më parë, të realizojë organizime turistike brenda dhe jashtë vendit, të organizojë ture shëtitëse, mund të shesë biletat e tureve të organizuara nga ana e agjensive të tjera të udhëtimit, të bëjë vetë ose nëpërmjet të tjerëve rezervime për këto, të realizojë transportin e udhëtarëve, të ofrojë shërbime këshillimi mbi turet dhe guidat, transportin, akomodimin dhe objektin e veprimtarisë, të rezervojë, të blejë dhe të shesë biletat për mjetet e transportit tokësor, detar dhe ajror.
- Prodhimi, blerja me shumicë dhe pakicë, shitja, shpërndarja, importi dhe eksporti i të gjitha llojeve të produkteve ushqimore.
- Hapja dhe funksionimi i dyqaneve të nevojshme të shitjeve me qëllim që të bëhen shitje me shumicë dhe pakicë për tregtimin e të gjitha llojeve të lëndëve ushqyese të nxehta, të ftohta, të ngrira, të thata dhe të përqendruara që kanë një efekt të rëndësishëm në ushqimin e njerëzve dhe janë subjekt i sektorit të ushqimit.
- Prodhimi, tregtia me shumicë dhe pakicë, shpërndarja, importi dhe eksporti i të gjitha llojeve të ushqimeve për fëmijë.
- Blerja, shitja, importi dhe eksporti me shumicë dhe pakicë, i të gjitha llojeve të mishit të viçit, bagëtisë, deleve, qengjit, dhisë. Blerja dhe shitja me shumicë dhe pakicë e të gjitha llojeve të mishit të shpendëve.
- Tregtia me shumicë dhe pakicë, importi dhe eksporti i të gjitha llojeve të ushqimeve të përgatitura me miell, sheqer dhe qumësht, të freskëta, frutave dhe perimeve, produkteve të drithërave, drithërave dhe bishtajoreve, kakaos, të gjitha llojeve të produkteve ushqimore të përgatitura në miell, të koncentruara, të konservuara dhe me shëllirë, të të gjitha llojeve të vajrave.
- Importi, eksporti, tregtia me shumicë dhe pakicë e suxhikut, sallamit, kremviçeve, pastërmasë, mishit të grirë, salcave, ketchup, salcave të domates, salcave të majonezës, salcave të sallatave dhe ingredientëve për sallatë.
- Tregtia me shumicë dhe pakicë, importi dhe eksporti i produkteve ushqimore të përbëra nga kërpudha të kultivuara dhe natyrale dhe i turshive të konservuara dhe produktet ushqimore të ngrira, të përbëra nga këto produkte.

- Blerja, shitja, tregtimi, importimi dhe eksportimi brenda dhe jashtë vendit i të gjitha llojeve të zorrëve të papërpunuara dhe origjinale të kafshëve dhe produkteve të zorrëve artificiale.
- Blerja, shitja, importimi, eksportimi, tregtia me shumicë dhe pakicë, tregtimi vetë ose nëpërmjet të tjerëve i perimeve dhe pemëve të freskëta, rrënjëve të ngrënshme, zhardhokëve, luleve dhe prodhimeve të tyre, bishtajoreve, qepës, hudhrës, susamit, sojës, bajameve, produkte të stikave të pishës, produkteve ushqimore të tilla si ullinj, lajthi, rrush të thatë, çaj dhe drithëra.
- Shitblerja, shpërndarja, importimi dhe eksportimi i ullinjve.
- Prodhimi, blerja me shumicë dhe pakicë, shitja, shpërndarja, importi dhe eksporti i të gjitha llojeve të vajit të ullirit, lulediellit, vajit të misrit, vajrave të lajthisë.
- Blerja, shitja, tregtimi, importi dhe eksportimi i të gjitha ushqimeve të freskëta dhe të thata, frutave, marmelatave, reçelëve, ushqimeve, pijeve pa sheqer dhe me sheqer dhe të gjitha produkteve ushqimore. Prodhimi, përpunimi, tregtimi, shërbimet e paketimit, importit dhe eksportit të të gjitha llojeve të perimeve të freskëta, të thata, të ngrira, frutave, luleve, bishtajoreve, drithërave, prodhimeve të produkteve bujqësore.
- Prodhimi, blerja dhe shitja e perimeve, frutave, farërave, fidanëve, të gjitha llojeve të bimëve të fushave dhe zbukuruese.
- Prodhimi, tregtimi, importimi dhe eksportimi i të gjitha llojeve të produkteve bujqësore të tilla si ushqime të konservuara, salcë domateje, marmelatë, reçel, shurup, pekmez, uthull.
- Kryerja e shërbimeve të konsulencës teknologjike për të gjitha llojet e çështjeve të lidhura me bujqësinë, sistemin e ambientit, realizimi i projekteve bujqësore, ndërmarrja dhe kontrolli i projekteve dhe investimeve.
- Tregtimi i paketimeve, tubave, materialeve të vaditjes dhe produkteve të tjera të bëra nga të gjitha llojet e qelqit, kartonit, plastikës dhe materialeve të tjera të përdorura në bujqësi.
- Tregtimi, marrja me qira dhe dhënia me qira, shërbimi, importimi dhe eksportimi i motorëve bujqësorë, pompave motorike, elektropompave, pompave centrifugale, automjeteve, traktorëve dhe pajisjeve, të gjitha llojeve të mjeteve, makinerive, pjesëve të këmbimit dhe aksesorëve.
- Krijimi, përdorimi, marrja me transferim, transferimi, ndërtimi, blerja dhe shitja, marrja me qira ose dhënia me qira e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, objekteve, vreshtave, kopshteve, tokave, serave, teknologjiv e bujqësore të nevojshme për aktivitetet në lidhje me objektin e veprimtarisë, vendosja mbi to e të gjitha llojeve të të drejtave reale dhe personale.
- Të kryejë të gjitha llojet e studimeve të zhvillimit, prodhimit dhe përmirësimit të fidanëve.
- Të importojë dhe të eksportojë të gjitha llojet e serave dhe teknologjive të serave, të sigurojë shërbime të konsulencës vendore dhe ndërkombëtare në këtë drejtim, të operojë me të gjitha llojet e serave.
- Krijimi, blerja, marrja me qira, dhënia me qira, shitja e ullishtave.
- Prodhimi, tregtimi, importimi dhe eksportimi i të gjitha llojeve të plehrave organikë dhe kimikë dhe pesticideve, pesticideve shtëpiake, medikamenteve veterinarë, të gjitha llojeve të kimikateve bujqësore dhe blegtorale dhe hormoneve të lidhura me analizën, rregullatorëve të rritjes së bimëve, të gjitha llojeve të plehrave kimike dhe natyrore.
- Blerja dhe shitja, importi dhe eksporti i tokës torfe.
- Tregtimi dhe brokerimi i të gjitha llojeve të pasurive të paluajtshme, të gjitha llojeve të makinave.
- Në përputhje me qëllimin e shoqërisë, mund të marrë të drejta materiale intelektuale dhe industriale siç është asistencë teknike e patentës së markës tregtare dhe mund t'i transferojë këto të drejta pjesërisht ose plotësisht.
- Të prodhojë, tregtojë, importojë dhe eksportojë pjesë këmbimi të të gjitha llojeve të automobilave, motoçikletave etj, produkteve dhe nënprodukteve të automjeteve. Të kryejë riparime dhe mirëmbajtje, të operojë në fushën e turizmit, të bëjë investime

SO 2
Përktyesa Zy
e Gjuhas T
Celt 16-32



turistike si në hotele, motele, hostale, kampe, karvane të çdo klase dhe kategorie, të operuarojë me to, t'i marrë me qira dhe t'i japë me qira. Hapja, operimi, dhënia me qira, marrja me qira e kafeterive, oborreve të çajit, tregjeve, qendrave tregtare. Pjesëmarrja në të gjitha llojet e tenderëve që lidhen me objektin e veprimtarisë, pjesëmarrja në rritjen dhe uljen e ofertave.

- Në lidhje me objektin e veprimtarisë shoqëria mund të bëjë kontrata të filialeve, agjensive dhe degëve të përfaqësimit.
- Në lidhje me objektin e veprimtarisë shoqëria mund të hyjë, të marrë, të shesë dhe të nënkontrakttojë çdo tender dhe angazhim të bërë ose të organizuar nga të gjitha llojet e enteve publike dhe private dhe nga ana e sektorit privat.
- Të përfitojë nga të gjitha llojet e stimuljeve dhe kredive, të bëjë investime, të marrë përsipër investime dhe stimujt.
- Për të realizuar qëllimin e shoqërisë, të krijojë, blejë, shesë, marrë me qira, japë me qira, ndërtojë, të alokojë dhe të heqë dorë nga të gjitha llojet e fabrikave, punëtorive, depove, ndërtesat administrative, ndërtesat e shërbimit dhe objektet përfaqësuese, të kryejë të gjitha llojet të kursimeve dhe aktiviteteve reale dhe personale.
- Në mënyrë që shoqëria të realizojë qëllimin e saj, për qëllimin e saj ekonomik dhe të biznesit mund të themelojë kompani të reja së bashku me persona realë dhe juridikë, dhe të marrë pjesë në kompani të themeluara.

Përveç çështjeve të sipërpërmendura, nëse në të ardhmen dëshirohet të ndërmerren dhe punë të tjera që do të konsiderohen të dobishme dhe të nevojshme për kompaninë, situata do të paraqitet për aprovim në bordin e aksionerëve me propozimin e bordit administrativ, dhe shoqëria do të jetë në gjendje të kryejë këto punë pasi vendimi të merret në këtë mënyrë. Leja e nevojshme do të merret nga autoritetet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi, i cili është në natyrën e një ndryshimi në statutin e shoqërisë. Ai do të regjistrohet dhe shpallet.

Selia e shoqërisë

Neni 4:

Selia e Shoqërisë është në Denizli. Adresa është: Bulevardi "Acıpayam", lagjia "Bağbaşı", kompleksi "Aksoy", nr. 53/B, Denizli. Në rast ndryshimi të adresës, adresa e re regjistrohet në Regjistrin Tregtar dhe botohet në Gazetën e Regjistrit Tregtar të Turqisë. Edhe pse mund të jetë larguar nga adresa e regjistruar dhe e publikuar, situata e krijuar si pasojë e mos regjistrimit brenda afatit të parashikuar të adresës së re konsiderohet si arsye për shpërbërje. Njoftimi që bëhet në adresën e regjistruar dhe publikuar konsiderohet si njoftim i bërë tek shoqëria. Shoqëria, me kusht që të njoftojë autoritetet përkatëse, mund të hapë degë brenda dhe jashtë vendit.

Kohëzgjatja e shoqërisë

Neni 5:

Kohëzgjatja e shoqërisë duke filluar nga data e regjistrimit dhe publikimit është 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

Kapitali i shoqërisë


Neni 6:

Kapitali i shoqërisë është 200.000.00,- (dyqind mijë) Lira Turke. Ky kapital është ndarë në 200 aksione, secili me vlerë 1,000,00- (një mijë) TL (Lira Turke).

Emri-Mbiemri i ortakut: Şükran Ersoy

Numri i aksioneve: 5

Totali: 5.000.00- TL (Lira Turke)



Emri-Mbiemri i ortakut: Bekir Ersoy
Numri i aksioneve: 195
Totali: 195000.00- TL (Lira Turke)



Kapitali i zhveshur nga çdo lloj falsifikimi është marrë plotësisht përsipër nga zotëruesit e akioneve. ¼-ta e kapitalit të shoqërisë do të paguhet jo më vonë se brenda tre muajve nga data e regjistrimit dhe shpalljes së shoqërisë, ndërsa pjesa e mbetur prej ¾-tave do të paguhet jo më vonë se brenda tre vjetëve. Borxhet mbi zotimet kapitale mund të kërkohen brenda vendimeve që do të merren nga bordi i aksionarëve dhe para datave të specifikuara duke marrë pëlqimin me shkrim të të gjithë ortakëve. Shpalljet në lidhje me këtë çështje bëhen në zbatim të nenit të publikimeve të Aktit të Themelimit.

Njoftimet shoqërisë

Neni 7:

Njoftimet që i përkasin shoqërisë në zbatim të dispozitave të nenit 37 të Ligjit Tregtar Turk bëhen minimalisht në një gazetë që botohet në vendin ku ndodhet selia e shoqërisë dhe njoftimi bëhet jo më vonë se shtatë ditë përpara publikimit.

Administrimi i shoqërisë

Neni 8:

Punët dhe procedurat e shoqërisë ndiqen nga drejtori ose drejtorët që zgjidhen nga ana e Bordit të Ortakëve. Këta drejtorë mund të zgjidhen ndërmjet ortakëve ose nga ersona që nuk janë ortakë të shoqërisë.

Njëri nga ortakët e shoqërisë, Şükran Ersoy, shtetas i Republikës së Turqisë, me adresë vendanimi: lagjia "İncilipınar", rruga "İstiklal", numër. 168/6, Denizli, është emëruar drejtor për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.

Përfaqësimi dhe përgjegjësitë

Neni 9:

Shoqëria përfaqësohet nga drejtorët. Nënshkrimet që do të përfaqësojnë shoqërinë konstatohen, regjistrohen dhe publikohen nga Bordi i Ortakëve.

Për të qenë të vlefshme të gjitha dokumentet dhe kontratat që do të lidhen nga ana e shoqërisë, është kusht që të mbajnë nënshkrimin e Raushan Tahiyev, drejtor i shoqërisë i autorizuar për përfaqësimin e shoqërisë, pasi ky nënshkrim të jetë vendosur poshtë emërimit të shoqërisë.

Periudha e llogarive

Neni 10:

Viti financiar i shoqërisë fillon në ditën e parë të muajit janar dhe përfundon në ditën e fundit të muajit dhjetor të çdo viti. Por viti i parë financiar i shoqërisë fillon nga data kur është krijuar në mënyrë permanente shoqëria dhe përfundon në ditën e fundit të muajit dhjetor të atij viti.

Shpërndarja e fitimit

Neni 11:

Fitimi neto i kompanisë është shuma e mbetur pas zbritjes së të gjitha llojeve të shpenzimeve të bëra, amortizimit dhe provizioneve nga të ardhurat e marra nga aktivitetet e shoqërisë. Para



fitimit neto, çdo vit caktohet fondi rezervë 5%. Pjesa e mbetur u shpërndahet aksionarëve në përpjesëtim me aksionet e tyre mbi kapitalin e paguar.

Fitimi neto i shoqërisë është vlera që përftohet pas zbritjes nga të ardhurat e periudhës të çdo lloji shpenzimi të bërë. Çdo vit nga fitimi neto ndahet 5% për fondin rezervë ligjor të përgjithshëm. 5% e sasisë së mbetur i shpërndahet poseduesve të kuotave si kuotë fitimi. Kuota e fitimi llogaritet në përputhje me pagesat që i ka bërë shoqërisë poseduesi i kuotës për kuotën e kapitalit themeltar. Nga sasia e vendosur për t'iu shpërndarë ortakëve me pjesëmarrësit në fitim, në zbatim të paragrafit numër 3, të pikës 2 të nenit 466 të Ligjit Tregtar Turk, duke u ndarë 10% i shtohet fondit rezervë të përgjithshëm. Shpërndarja e një pjese të fitimit ortakëve dhe përdorimi i tij në emër të shoqërisë ose dhënia e tij si shpërblim për nëpunësit, punëtorët, është e lidhur me vendimin e ortakëve që përfaqësojnë minimalisht pesëdhjetë e një për qind (51%) të kapitalit të shoqërisë.

Fondi rezervë

Neni 12:

Fondi rezervë ndahet deri sa kapitali i shoqërisë të kalojë 20%-in. Në rast se kjo sasi zvogëlohet, vazhdohet sërish me ndarjen e fondit rezervë. Në zbatim të fondeve rezervë ligjore dhe vullnetare dhe në mbështetje të dispozitave të ligjit dhe statutit, sa kohë që sasia e nevojshme nuk rezervohet nga fitimi neto, ortakëve nuk iu shpërndahet fitimi.

Dispozitat ligjore

Neni 13 :

Në lidhje me çështjet që nuk përmenden në këtë akt themelimi, aplikohen dispozitat e Kodit Tregtar Turk.

Themeluesit

Bekir Ersoy Nënshkrimi

Şükran Ersoy Nënshkrimi

Data e vendimit: 27.12.2011

Nr. rendor i vendimit: 1

Përmbledhja e vendimit: Mi shpërndarjen e detyrave dhe nënshkruesit e autorizuar

Pjesëmarrësit në mbledhje: Bekir Ersoy Şükran Ersoy

Teksti i Vendimit

Ortakët e shoqërisë të mbledhur në selinë e shoqërisë morrën vendimet e mëposhtme:

Şükran Ersoy, një nga ortakët e shoqërisë, është vendosur unanimisht që për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh të përfaqësojë kompaninë nën emrin tregtar dhe vulën e shoqërisë me një nënshkrim që do të nënshkruhet individualisht, i cili autorizohet të kryejë veprimet si më poshtë:

Të marrë leje për të ndjekur punët e shoqërisë tonë, si dhe për të printuar dhe ndjekur të gjitha dokumentet pranë të gjitha ndërmarrjeve shtetërore, enteve ekonomike shtetërore, departamenteve me buxhet të shtuar dhe të veçantë, pra të gjithë personave realë dhe juridikë, bankave, Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, Drejtoritë së Këmbimeve me Jashtë, Sindikatave, Institucioneve, Shoqatave, Drejtorisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Zyrave të Taksave, Dhomave dhe Bursave, të pranojë heqjen dorë nga të tjetër ose të tëhiqet vetë nga paditë e ngritura pranë Gjykatave Rajonale Administrative, Zyrave të Tapive, të ngrerë padi, të lëshojë prokurë përfaqësimi për paditë që do të ngrihen dhe të shkarkojë përfaqësuesit e caktuar, të kryejë procedurat e hipotekimit pranë zyrës së tapive, të anulojë hipotekat, t'i fshijë kur është e nevojshme, të bëjë të gjitha llojet e transaksioneve bankare, të tërheqë dhe të depozitojë para, të përfundojë plotësisht të gjitha punët, të kryejë dhe përfundojë të gjitha llojet e transaksioneve

Manjola SOPOTI
Përkthyes Zyrtar
e Gjuhës Turke
Cel: 0682022177

të këmbimit valutor, të vendosë në emër të shoqërisë detyrime të parave cash dhe jo cash, të kryejë transaksione me letra krediti, të kryejë të gjitha llojet e transaksioneve në të gjitha bankat në mbledhjen e të gjitha llojeve të të arkëtueshmeve, pagesave të borxheve, të kryejë të gjitha veprimet në të gjitha llojet e kontratave, marrëveshjet e qirasë, të ekzekutojë angazhimet, të kryejë transaksionet që do të bëhen në emër të kooperativës, të kryejë të gjitha procedurat që kanë lidhje me angazhimet dhe kursimet, të kryejë shitjen nëpërmjet tenderimit të pasurive të paluajtshme të shoqërisë përkundrejt të gjithë personave realë dhe juridikë në bashkëpunim me shtetin, entet ekonomike shtetërore, zyrtar me buxhet të shtuar ose të veçantë, të marrë, të lëshojë tapi në emër të shoqërisë tonë, të nënshkruajë fshirjen nga regjistrat e këtyre, të hipotekojë pasuritë e paluajtshme që i përkasin shoqërisë tonë, të ndjekë të gjitha procedurat përkatëse në lidhje me të gjitha llojet e kredive dhe garancive në banka, në të gjitha transaksionet në lidhje me hipotekën dhe zgjidhjen e hipotekës gjatë vendosjes së hipotekës në emër të shoqërisë dhe gjatë fshirjes së hipotekave të marra.

Şukran Ersoy Nënshkrimi
272 983 46 764
Bekir Ersoy Nënshkrimi
19165617770

(10/A)(2/3321)

Shënim i përkthyeses: Në fundin e çdo flete të dokumentit, ndodhet:

- Vulë: NJËSIA ME ORIGINALIN.
- Vulë-Nënshkrim i Nebahat ADIGÜZEL, Drejtor i Regjistrat Tregtar të Denizli-Vulë.

Manjola SOÇOLI
Përkthyes e Gjuhës
e Gjuhës
Cel: 068 091 777

APOSTILLE
(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)

1. Ülke/Country/Pays/Staat TÜRKİYE - LA TURQUIE

İşbu resmi belge/This public document/Le présent acte public/Dieses zeugnis wurde

2. Nebahat ADIGÜZEL tarafından imzalanmıştır./Has been signed by/a été signé par/durch ...
unterschrieben

3. İmzalayanın sıfatı Ticaret Sicli Müdürü'dür./Acting in the capacity of/Agissant en qualité de/Titel
des Unterzeichneten

4. Denizli Ticaret Odası 'nin mühür/damgasını taşımaktadır-bears the seal/stamp of-/est revéu du
sceau/timbre de-trägt Siegel/Stempel von

TASDİK / CERTIFIED / ATTESTE / BEGLAUBIGUNG:

